

UDHËZUES PËR BIZNESIN

BËNI BIZNES TË PASTËR!

Të luftojmë së bashku kundër mashtrimit me pijet alkoolike



Partneriteti Biznes-Doganë Kundër Mashtrimit me Pijet Alkoolike

Ky njoftim u drejtohet të gjithë menaxherëve dhe punonjësve të pikave të shitjes me shumicë e pakicë të pijeve alkoolike.

Mbroni biznesin tuaj....

- Mos tregtoni pije alkoolike të paligjshme (p.sh. pa pullë), me apo pa vetëdije
- Penalitete të rënda aplikohen për këdo që magazinon dhe tregton produkte të paligjshme
- Merrni masat e duhura për të mbrojtur biznesin dhe zinxhirin tuaj të furnizimit nga mashtrimet
- Ndërgjegjësoni stafin lidhur me elementët dallues të produkteve dhe furnitorëve të paligjshëm
- Raportoni çdo produkt apo aktivitet të dyshimtë pranë Doganës, duke telefonuar falas në Numrin Jeshil



0800 22 22



Pikat e shitjeve dhe konsumatorët në Shqipëri janë të rrezikuar nga furnitorë mashtrues, të cilët tregtojnë pije alkoolike të paligjshme (p.sh. pa pullë) dhe madje të falsifikuara. Administrata Doganore po i kushton vëmendje të veçantë produkteve të cilat tregtohen në pikat e vogla, të mesme dhe të mëdha të shitjes në të gjithë vendin, me qëllim parandalimin e dëmit që i shkaktohet konsumatorëve, ekonomisë dhe bizneseve të përgjegjshme e të ligjshme nga këto produkte.

Janë identifikuar shumë raste të tregtimit të pijeve alkoolike pa pullë ose me pulla fiskale të falsifikuara, çka ka çuar në konfiskimin e mallrave të dyshuara, si dhe vënien e gjobave për shitësit.

Shitësit e papërgjegjshëm të pijeve alkoolike, të cilët shmangin pagesën e detyrimeve të akcizës, kanë një avantazh konkurrues të dukshëm sepse ata mund t'i shesin pijet alkoolike me një çmim më të lirë, ose mund të operojnë me marzh më të lartë fitimi. Administrata Doganore, në partneritet me shitësit e përgjegjshëm, mund t'i thonë NDAL këtij fenomeni. Ky njoftim shpjegon penalitetet të cilat aplikohen në rastet e tregtimit të pijeve alkoolike të paligjshme, si dhe ju këshillon se si mund të njihni elementët dallues të produkteve të paligjshme përpara se t'i shkaktohet ndonjë dëm biznesit apo reputacionit tuaj.



Penalitetet për kundërvajtësit

Për çdo shitës i cili zotëron apo tregton pije alkoolike të paligjshme aplikohen penalitete në bazë të ligjit “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”;

Në përputhje me nenet **41, 94, 95** dhe **96** të këtij ligji:

- Pulla fiskale duhet të ngjitet/të stampohet në shishe ose në ambalazh tjetër, në mënyrë të tillë që të jetë e dukshme dhe të griset/bëhet e papërdorshme kur hapet tapa (Shënim: Në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 19 datë 19.01.2011 mund të gjenden më shumë detaje mbi mënyrën e vendosjes së pullave fiskale).
- Mbatja, transportimi ose shitja e mallrave të akcizës pa pulla fiskale, përveç ndjekjes penale, dënohet me gjobë sa 2- deri 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar, si dhe me konfiskim të mallrave.
- Vendosja e pullave të falsifikuara apo manipuluar, si edhe falsifikimi, manipulimi apo ripërdorimi i tyre për të shmangur pagesën e akcizës, përveç ndjekjes penale, dënohen me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve fiskale që duheshin paguar.
- Produktet e akcizës që transportohen pa dokumentacionin përkatës, me dokumentacion të falsifikuar ose të korrigjuar, apo që nuk lejon të identifikohet subjekti që kryen transportin, konsiderohen me prejardhje të paligjshme. Në këto raste, transportuesi dhe dërguesi solidarisht dënohen me gjoba nga 2- deri në 5-fishin e detyrimeve fiskale që duheshin paguar.



Për informacion të mëtejshëm në lidhje me instrumentet ligjore dhe procedurat doganore mbi prodhimin, lëvizjen, mbajtjen dhe shitjen e produkteve të akcizës, mund t'i referoheni faqes zyrtare të Administratës Doganore www.dogana.gov.al, ose mund të kontaktoni Departamentin e Akcizës (Drejtoria e Metodikave dhe Kontrollit) në numrin e telefonit: **0422859044**.



Mbroni biznesin tuaj nga mashtrimi

Në mënyrë që të mbroni biznesin tuaj nga mashtrimi, ju duhet të siguroheni për besueshmërinë dhe ligjshmërinë e furnitorëve dhe furnizimeve tuaja. Nëse keni ndonjë dyshim, pyesni furnitorët tuaj në lidhje me:

- Burimin e produkteve që po ju ofrojnë;
- Termat dhe kushtet e pagesës (duke përfshirë detyrimin për t'ju pajisur me faturë të rregullt tatimore);
- Detaje mbi lëvizjen e këtyre produkteve;
- Likuidimin e detyrimeve fiskale për produktet në fjalë.

Në rastet kur keni të bëni drejtpërdrejt me produkte alkoolike të cilat janë objekt i pagesës së akcizës, ju duhet të siguroheni që detyrimet janë paguar. Nëse po i blini këto produkte nga furnitorë të cilët nuk i njihni mirë, ju rekomandojmë që të siguroheni se furnitori është në gjendje t'ju vërë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm i cili vërteton se detyrimet janë paguar.



Një verifikim më i kujdesshëm i furnitorëve dhe furnizimeve, i jep mundësinë biznesit të ndershëm të kontribuojë në mbylljen e shtigjeve të përdorura nga rrjetet e organizuara të mashtrimit. Prandaj është e rëndësishme, veçanërisht për pikat e mëdha të shitjes, që kjo të kthehet në praktikë të përhershme pune për të gjithë stafin, përfshirë menaxherët dhe personat përgjegjës për financat, çështjet ligjore, shitjet, magazinimin dhe transportimin, të cilët duhet të jenë të vëmendshëm ndaj elementeve mashtrues.

Një mënyrë për të arritur këtë është përfshirja e këtyre lloj verifikimeve në Procedurat Standarde të Veprimit të kompanisë, si dhe trajnimi i personelit në këtë drejtim.

Elementët dallues të cilët tregojnë se detyrimet e akcizës janë shmangur përfshijnë:

- Mallra që ju ofrohen nëpërmjet furnizimeve të pa-porositura, nga persona apo kompani të cilat ju nuk i njihni;
- Të dhëna të mangëta lidhur me identitetin e furnitorit, p.sh. ju paraqitet vetëm një emër dhe një numër celulari, por jo të dhëna për adresën, apo numri i regjistrimit të tatimpaguesit;
- Mallra të cilat ju ofrohen me çmime mjaft më të ulëta se çmimet normale të tregut;
- Furnitorë të cilët ngulmojnë që pagesa të kryhet vetëm në *cash* (para në dorë);
- Furnitorë të cilët nuk japin fatura të vlefshme shitjeje, p.sh. fatura që përmbajnë emër dhe adresë të paplotë të furnitorit, apo fatura pa numër regjistrimi të tatimpaguesit;
- Mungesë të pullave fiskale, pulla fiskale jo-fluoreshente, pulla të ngjitura në mënyrë jo-korrekte tek paketimi, ose që kanë cilësi të dobët printimi (shikoni më poshtë);
- Produkte të cilët duken si të falsifikuar, nisur nga elementë të tillë si cilësia e etiketës, ambalazhi, paketimi i produktit, madje dhe ngjyra e lëngut në vetvete, e cila është e ndryshme po të krahasohet me produktin origjinal.



Nëse ju lindin dyshime rreth besueshmërisë së furnizimit ose furnitorit, ju rekomandojmë që të shmangni blerjen e produkteve të dyshimta si dhe t'i porosisni mallrat në një burim të sigurt. Në rast se dyshoni për mashtrim, duhet të njoftoni Administratën Doganore lidhur me shqetësimet tuaja nëpërmjet **numrit jeshil** i cili është në dispozicionin tuaj 24 orë të ditës/ 7 ditë të javës.



0800 22 22

Procedura e kontrollit të originalitetit të pullave fiskale

Pullat fiskale në Shqipëri përmbajnë elementë mjaft të sofistikuar, me shenja unike dalluese kundër falsifikimit dhe manipulimit, përfshirë:

- Siguri materiale, si p.sh. boja e sigurisë
- Siguria e dizajnit dhe printimit, si p.sh. elementë dizajni të sofistikuar
- Siguri dixhitale përfshirë kode të dukshëm të kriptuar dhe të dhëna në formë teksti
- Siguri anti-manipulim si p.sh. prerjet e sigurisë

Në disa raste, falsifikuesit ia kanë dalë të fotokopjojnë me ngjyra pullat fiskale. Këto pulla mund të dallohen përmes një kontrolli me sy të lirë nëse janë false apo origjinale. Gjithsesi, në rase se keni dyshime, pullat fiskale të dyshimta mund të identifikohen lehtësisht duke përdorur skanerin e dorës, mjet i cili është në dispozicion të grupeve operative të Doganës.

Si të njihni një pullë të sigurt fiskale?



Me ndihmën e partnerit tonë SICPA Albania sh.p.k., nëpërmjet këtij udhëzimi ju ofrojmë një mjet që i mundëson përdoruesit kryerjen e veprimeve të thjeshta për të kontrolluar vërtetësinë e pullave fiskale.



FAMILJA E PULLAVE FISKALE TË SIGURTA TË ALKOOLIT

JANË NË DISPOZICION 6 PULLA TË NDRYSHME SIGURIE DHE 1 SHËNJIM:

1. Pullat vetëngjithëse shishe dhe kanaçe birre të importuar



2. Shënjim dixhital për shishet dhe kanaçet e birrës vendase



3. Pulla vetëngjithëse për fuçitë e birrës



4. Pulla vetëngjithëse për verën



5. Pulla vetëngjithëse për pijet e distiluara



6. Pulla vetëngjithëse për rakinë



1. SHISHE DHE KANAÇE BIRRE TË IMPORTUAR

KONTROLLONI 2 NIVELE TË SIGURISË



Pullë rrumbullake
Diametri = 19 mm



1

SIGURIA E DIZAJNIT

KONTROLLONI PRANINË E TEKSTEVE TË MËPOSHTME



«Birrë»



«Ministria e financave»

KONTROLLONI PRANINË E EMBLEMËS SË SHQIPËRISË ME SHQIPONJËN DYKRENARE



2


SIGURIA E DIZAJNIT

KONTROLLONI PRANINË E KODIT DIXHITAL



Kod sigurie 2D

2. SHISHE DHE KANAÇE BIRRE VENDASE



1

SIGURIA DIXHITALE


KONTROLLONI PRANINË E KODIT DIXHITAL




Kod sigurie 2D

3. FUÇI BIRRE

KONTROLLONI 3 NIVELE
TË SIGURISË



3 KUNDËR MANIPULIMIT
KONTROLLONI PRANINË
E PRERJEVE TË SIGURISË



Banderolë fuçie
100x14mm

1 SIGURIA E DIZAJNIT



KONTROLLONI PRANINË E TEKSTIT TË MËPOSHTËM



«SHQIPËRISË»

KONTROLLONI PRANINË E EMBLEMËS SË SHQIPËRISË ME
SHQIPONJËN DYKRENARE



2 SIGURIA E DIZAJNIT
KONTROLLONI PRANINË E KODIT DIXITAL



Kod sigurie 2D

4. SHISHE VERE

KONTROLLONI 4 NIVELE TË SIGURISË




4 KUNDËR MANIPULIMIT
KONTROLLONI PRANINË
E PRERJEVE TË SIGURISË



Banderolë vere
100 x 14 mm



1 SIGURIA E MATERIALIT
KONTROLLONI BOJËN ME NDËRRIM NGJYRE



2 SIGURIA E DIZAJNIT
KONTROLLONI PRANINË E TEKSTIT TË MËPOSHTËM



3 SIGURIA E MATERIALIT
KONTROLLONI BOJËN E POLARIZUAR
DUKE PËRDORUR VALIDUESIN SICPA




5. ALKOOL I DISTILUAR SHISHE


KONTROLLONI 4 NIVELE TË SIGURISË



4 KUNDËR MANIPULIMIT
KONTROLLONI PRANINË
E PRERJEVE TË SIGURISË



Banderolë pijesh
alkoolike të distiluara
100 x 14 mm



1 SIGURIA E MATERIALIT
KONTROLLONI BOJËN ME NDËRRIM NGJYRE




2 SIGURIA E DIZAJNIT
KONTROLLONI PRANINË E TEKSTIT TË MËPOSHTËM



«SHQIPËRISË»

KONTROLLONI PRANINË E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT
Reshti i parë: "Import" ose "vendas"
Reshti i dytë: Vëllimi në litra (0.XXL)



3 SIGURIA E MATERIALIT
KONTROLLONI BOJËN E POLARIZUAR
DUKE PËRDORUR VALIDUESIN SICPA




6. SHISHE RAKIE


KONTROLLONI 4 NIVELE
TË SIGURISË



4 KUNDËR MANIPULIMIT
KONTROLLONI PRANINË
E PRERJEVE TË SIGURISË



Banderolë rakie
100 x 14 mm



1 SIGURIA E MATERIALIT
KONTROLLONI BOJËN ME NDËRRIM NGJYRE




2 SIGURIA E DIZAJNIT
KONTROLLONI PRANINË E TEKSTIT TË MËPOSHTËM



« SHQIPËRISE »

KONTROLLONI PRANINË E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT
Rreshti i parë: "Import" ose "vendas"
Rreshti i dytë: Vëllimi në litra (0.0XXL)



3 SIGURIA E MATERIALIT
KONTROLLONI BOJËN E POLARIZUAR
DUKE PËRDORUR VALIDUESIN SICPA




Si të dallojmë rastet kur pullat fiskale nuk janë vendosur siç duhet apo mungojnë?

Kontrollet doganore kanë identifikuar gjithashtu një sërë rastesh të mos vendosjes korrekte të pullave fiskale mbi ambalazh, ose raste kur pullat mungojnë plotësisht (shikoni shembujt më poshtë). Dogana ka autoritetin ligjor të konfiskojë mallra dhe të vendosë sanksione administrative, prandaj shitësit duhet të jenë gjithnjë në gatishmëri për të identifikuar dhe raportuar të tilla raste menjëherë pranë Doganës.


Shishe Vere




Shishe Birre



Kanaçe Birre



Fuçi Birre



Si të raportoni një pullë fiskale të dyshimtë?

Në rast se keni dyshime rreth origjinalitetit ose vendosjes së pullës fiskale në produktet që ju do t'i blini ose i zotëroni, mos i shisni këto produkte dhe ndiqni këto katër hapa bazë:

Mbani shënim ku, kur dhe detaje të tjera në lidhje me mënyrën si u furnizuat (nëse është e mundur, bëni edhe fotografi të pullave të dyshimta dhe të produkteve);

- *Mos tentoni të hiqni pullën fiskale nga produkti;*
- *Ndani veçmas dhe mbani në një vend të veçantë e të sigurt produktet e pajisura me pulla të dyshimta;*
- *KONTAKTONI FALAS NUMRIN JESHIL TË DOGANËS PËR TË RAPORTUAR DYSHIMET TUAJA (të gjitha telefonatat tuaja trajtohen me konfidencialitet)*



0800 22 22



Angazhimi ynë si partner pro-aktiv i biznesit

Administrata Doganore Shqiptare është e angazhuar të ofrojë standardet më të larta të shërbimit për konsumatorët dhe bizneset. Ne vlerësojmë tregtarët e ndershëm të cilët bëjnë përpjekje maksimale për të përmbushur detyrimet ligjore dhe do t'u ofrojmë atyre këshilla dhe udhëzime të mëtejshme. Shitësit, të cilët qëllimisht nuk përmbushin detyrimet ligjore, rrezikojnë të përballen me konfiskim të mallrave dhe me penaltete.

